

Mundësi për aplikim të bashkive në thirrjen “Town Twinning 2026” – CERV-2026-CITIZENS-TOWN-TT

Synimi i Thirrjes:

Thirrja synon të mbështesë bashkëpunimin dhe shkëmbimet ndërmjet qytetarëve të vendeve të ndryshme përmes binjakëzimit të qyteteve/bashkive. Qëllimi është forcimi i mirëkuptimit të ndërsjellë, i pjesëmarrjes demokratike, i identitetit europian, i vlerave të BE-së, i gjithëpërfshirjes dhe i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve vendore në BE dhe në shtetet kandidate.

Fushat e veprimit të thirrjes:

Projektet duhet të fokusohen tek pjesëmarrja aktive qytetare dhe demokratike në nivel vendor, përfshirja, barazia dhe respekti për diversitetin, ndërgjegjësimi mbi vlerat dhe të drejtat e BE-së, forcimi i vlerave sociale dhe i besimit të institucionet, parandalimi dhe ndërgjegjësimi kundër dhunës, pjesëmarrja kulturore dhe trashëgimia, si edhe aksesueshmëria dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

Në këtë thirrje mund të aplikojnë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, shoqatat e autoriteteve vendore ose organizatat jofitimprurëse që përfaqësojnë autoritetet vendore. Aplikimi bëhet nga një aplikant i vetëm si përfitues kryesor, por projekti duhet të përfshijë bashki nga të paktën dy shtetet e pranueshme, ku të paktën njëri shtet duhet të jetë Shtet Anëtar i BE-së. Shqipëria është vend pjesëmarrës në programin CERV për të gjitha fushat, përveç fushës Vlerat e Unionit (Union Values), prandaj bashkitë shqiptare mund të marrin pjesë në këtë thirrje.

Për të gjetur partnerë mund të përdorni rubrikën **Partner search announcements** në portalit e BE-së: EU Funding & Tenders, ose në linkun: <https://eu.jotform.com/tables/230111180557041>

Aktivitete të pranueshme:

Aktivitetet e pranueshme përfshijnë seminare, workshop-e, konferenca, trajnime, takime ekspertësh, aktivitete ndërgjegjëse, evente kulturore, festivale, ekspozita, konsultime qytetare, mbledhje dhe analizë të të dhënave, shkëmbim praktikash të mira ndërmjet bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile, përdorim të rrjeteve sociale dhe mjeteve të komunikimit, si dhe aktivitete që nxisin pjesëmarrjen qytetare në proceset demokratike. Eventet online mund të jenë pjesë e projektit, por nuk llogariten për financim apo për numrin minimal të pjesëmarrësve.

Periudha e zbatimit të projekteve:

Projektet duhet të zgjasin nga 6 deri në 12 muaj.

Buxheti i thirrjes:

Buxheti total i thirrjes është 6.000.000 euro. Për çdo projekt individual, buxheti i pritshëm është nga 8.455 euro deri në 50.745 euro, në varësi të numrit të përfituesve.

Si bëhet aplikimi:

Aplikimi bëhet vetëm online përmes portalit të BE-së: EU Funding & Tenders: <https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/home>. Fillimisht duhet të krijohet llogaria juaj personale në EU Login. Pastaj nga profili personal duhet të krijohet profili i subjektit, që pasi të regjistrohet ju pajis me kodin PIC, i cili është kodi identifikues i subjektit tuaj.

Dokumentat që duhen përgatitur:

- Pjesa A që partneri kryesor e plotëson online në portalin EU Funding & Tenders.
- Pjesën B që parnerët e shkarkojnë dhe e plotësojnë sëbashku dhe partneri kryesor e ngarkon në platformë.
- Pjesa C që partneri kryesor e plotëson online në portalin EU Funding & Tenders.
- Shtojcat e detyrueshme dhe dokumentet mbështetëse që shkarkohen nga Portali, të cilat duhet plotësohen, të mblidhen dhe të ringarkohen në portal:
 - Lista e projekteve të mëparshme (projektet kryesore për 4 vitet e fundit) (shabloni i disponueshëm në Pjesën B). Nuk zbatohet për subjektet e sapokrijuara;
 - Bashkitë mund të kalojnë të drejtën e tyre tek një organizatë e shoqërisë civile për të aplikuar në vendin e bashkisë përmes një letre mbështetëse e cila duhet të nënshkruhet nga Bashkia dhe ngarkohet në portal gjatë fazës së aplikimit;
 - Subjektet private që përfshijnë drejtpërdrejt fëmijët në aktivitetet e projektit duhet të ngarkojnë evidencë të një Politike për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMP) që mbulon katër fushat e përshkruara në Mbajtjen e Fëmijëve të Sigurt, Standardet e Mbrojtjes së Fëmijëve. Duhet gjithashtu të përfshijë procedura dhe rregulla të qarta për stafin, duke përfshirë rregullat e raportimit dhe trajnimin e vazhdueshëm.
 - Subjektet publike (Bashkitë) mund ta përmbushin detyrimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMP) duke paraqitur një deklaratë nderi nga Kryetari i Bashkisë, ku deklarohet se masat e mbrojtjes së fëmijëve të subjektit publik janë në përputhje me parimet dhe standardet e përshkruara në Standardet e Mbrojtjes së Fëmijëve për Mbajtjen e Fëmijëve të Sigurt.

Kur është afati i fundit:

Afati i fundit për dorëzim është **23 shtator 2026, ora 17:00 CET**, me oren e Brukselit.

Linku i Thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2026-CITIZENS-TOWN-TT?order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate&keywords=CERV-2026-CITIZENS-TOWN-TT&isExactMatch=true&status=31094502&frameworkProgramme=43251589>